



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** Nr. KSC-CC-PR-2017-01

**Vendosi:** **Kryetarja e Dhomave të Specializuara**  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 26 prill 2017

**Titulli:** Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit  
19(5) të Ligjit

**Publik**

---

**Urdhër mbi riklasifikimin e Shtojcës A të Referimit të Rregullores së Procedurës  
dhe Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese**

---

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), pasi ka marrë një kërkesë nga kryetarja e panelit të Gjykatës Kushtetuese për riklasifikimin e Shtojcës A si publike, e cila i bashkëngjitet parashtrimit “Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese”,<sup>1</sup> riklasifikon Shtojcën A, sikurse është kërkuar.

1. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare (“Plenare”), me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”).

2. Më 27 mars 2017, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, Kryetarja i referoi Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”), për shqyrtim Rregulloren e miratuar nga Plenarja.<sup>2</sup> Rregullorja iu bashkëngjiti referimit si shtojcë me klasifikim konfidencial për të garantuar fshehtësinë e kuvendimeve të panelit të Gjykatës Kushtetuese.

3. Më 26 prill 2017, kryetarja e panelit të Gjykatës Kushtetuese parashtroi një kërkesë që Shtojca A të bëhej publike, duke qenë se kuvendimet kanë mbaruar dhe për të ndihmuar në kuptimin e aktvendimit të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese mbi përputhshmërinë e Rregullores me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarja, Nr. KSC-CC-PR-2017-01, 27 mars 2017 (“Referimi”).

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Mesazh elektronik i kryetares së panelit të Gjykatës Kushtetuese drejtuar Kryetares, 26 prill 2017, 10:14am.

**PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA**

**riklasifikon publike Shtojcën A** bashkëngjitur në “Referim i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese”, nr. KSC-CC-PR-2017-01, me datë 27 mars 2017.

/nënshkrim/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova  
Kryetare

E mërkurë, 26 prill 2017

Në Hagë, Holandë